



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORAT

Nr. 803 Prot

Gjirokastrë, më 14.05, 2025

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho ~~CANA~~



Lënda: Hapet thirrja për shfaqjen e projekt propozimesh në kuadër të Programit "Interreg IPA ADRION".

Në kuadër të Programit **Interreg IPA ADRION**, është hapur thirrja e re për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Interreg IPA ADRION	30 qershor 2025

Fushat prioritare të kësaj thirrjeje janë si vijon:

1. Forcimi i kapaciteteve të inovacionit:

- Zhvillimi i strategjive ndërkombëtare veçanërisht në sektorët kryesorë si: shëndeti dhe cilësia e jetës, ushqimi i sigurt, turizmi i qëndrueshëm dhe ekonomia krijuese.
- Promovimi dhe inkurajimi i zhvillimit të inovacioneve të dizajnuara përmes veprimeve pilot dhe të përbashkëta që kontribuojnë në përballimin e sfidave shoqërore si ndryshimi demografik.
- Mbështetja e reduktimit të hendekut dixhital duke adresuar zhvillimin e qëndrueshëm, rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe adresimin e mirëqenies, duke përfshirë shëndetin për të rinjtë dhe të moshuarit, kujdesin spitalor dhe në shtëpi, duke marrë në konsideratë trendin e ndryshimeve demografike.

- Zhvillimi dhe zbatimi i shërbimeve elektronike si: qeverisja elektronike, mësimi elektronik, marketingu elektronik ose mjetet dixhitale për prodhimin industrial.
2. Mbështetja e një Rajoni Adriatiko-Jonian më të gjelbër dhe më qëndrueshëm ndaj klimës:
- Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësi natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu.
 - Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit.
3. Mbështetja në ndërtimin e një Rajoni Adriatiko-Jonian me bashkëpunim më të mirë dhe mbështetja e qëndrueshmërisë ndaj emetimeve të karbonit:
- Zhvillimi dhe testimi i mjeteve/zgjidhjeve inovative të planifikimit që parashikojnë kërkesën e ardhshme për transport publik duke pasur parasysh ndikimin e shkaktuar nga ndryshimet aktuale socio-demografike dhe situata aktuale pandemike në lëvizshmërinë kombëtare, rajonale dhe lokale.
 - Zbatimi i planeve të integruara ndërkombëtare të veprimit që mbështesin zhvillimin e transportit hekurudhor dhe detar.
 - Hartimi i boshllëqeve infrastrukturore, teknologjike, legjislativ dhe barrierave në qarkullimin e mallrave, duke përfshirë ndryshimet ligjore dhe administrative që pengojnë efikasitetin e transportit të qetë ndërkombëtar, me qëllim krijimin e një kuadri të përbashkët të politikave ndërkombëtare të transportit.

Thirrjen, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e Interreg IPA ADRION: (<https://www.interreg-ipa-adrion.eu/calls/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv. Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj